



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:116854
Datë: 04.11.2024
Numri i dokumentit: 06395490

Kom.Dh.Shk.II.nr.1262/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Dytë, në përbërje nga gjyqtari individual Faton Bajrami, në çështjen përmbare të kreditorit NPT “HSB-Commerce”- Hyzri Zeqiri B.I., me seli në Viti, fshati Radivojc, kundër debitorit “Positive Bar” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, Rruga C, Mati 1, e përfaqëson me autorizim Rexhep Podvorica, avokat nga Prishtina, në bazë juridike përmbare, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1311/23, të datës 01.03.2024, me datë 01.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit NPT “HSB-Commerce”- Hyzri Zeqiri B.I., me seli në Viti, fshati Radivojc, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1311/23, të datës 01.03.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1311/23, të datës 01.03.2024, në pikën I të dispozitivit, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Positive Bar” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, Rruga C, Mati 1, i ushtruar kundër Urdhrit të Përmbaresit Privat Kushtrim M. Musa P.nr.211/2023 të dt. 16.05.2023, dhe ka përfunduar përmbaremi në këtë çështje përmbare. Në pikën II të dispozitivit ka detyruar kreditorin që në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimi t’ia paguaj debitorit shumën e përgjithshme prej 208 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes

faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovojë si të bazuar ankesën e kreditorit, dhe kjo çështje ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala debitorit.

Gjykata Komerciale, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori NPT “HSB-Commerce”- Hyzri Zeqiri B.I., me seli në Viti, fshati Radivojc, ka paraqitur propozim për përmbartim, kundër debitorit Positivie Bar” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, Rruga C, Mati 1ë, në bazë të dokumentit të besueshëm – Fatura Nr.49-2017 e datës 01.11.2017 dhe Fatura Nr. 52-2017 e datës 07.11.2017, në emër borxhit për shumën e mjeteve, në lartësi prej 3,500.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Përmbartuesi privat Kushtrim M. Musa, duke vepruar në bazë të propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.211/2023 të dt. 16.05.2023, ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori, ka ushtruar prapësim duke theksuar se faturat nga data e lëshimit deri në fillimin e procedurës përmbartimore i bie që kërkesat janë parashkuar konform dispozitave të LMD-së, sipas nenit 355 par.1 të LPP-së dhe këto fatura nuk janë të pranuar nga debitori pra jën të njëanshme, andaj i propozon gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi dhe të anulohet urdhërin përmbartimor.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori, duke theksuar se janë të pa bazuara pretendimet e debitorit në prapësim dhe se e kundërshton kërkesën e debitorit që të mos realizohet përmbartimi duke theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit pasi që fatura i plotësojnë kushtet ligjore sipas LPP-së, duke qenë se faturat janë të nënshkuara dhe origjinale, andaj edhe ka kërkuar që të refuzoi prapësimin, dhe urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1311/23, të datës 01.03.2024, në pikën I të dispozitivit, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Positivie Bar” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, Rruga C, Mati 1, i ushtruar kundër Urdhrit të Përmbartuesit Privat Kushtrim M. Musa P.nr.211/2023 të dt. 16.05.2023, dhe ka përfunduar përmbartimi në këtë çështje përmbartimore. Në pikën II të dispozitivit ka detyruar kreditorin që në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimi t’ia paguaj debitorit shumën e përgjithshme prej 208 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës ka gjetur se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbartim të dokumentit të besueshëm - Fatura nr. 49-2017 është lëshuar me date 01.11.2017 dhe është bërë e arritshme me date 04.11.2017, ndërsa Fatura nr. 52-2017 është lëshuar me date 07.11.2017 dhe është bërë

e arritshme për pagës me date 07.12.2017, në anën tjetër propozimi për përmbarrim në raport me këto fatura nga ana e kreditorit ishte paraqitur me datë 16.05.2023, dhe rrjedhimisht borxhi i cili buron nga faturat mbi bazën e se cilave është lejuar urdhri për përmbarrim, është përfshirë në parashkrim, kjo në përputhje me nenin 355, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili përcakton se: *"Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. 2. Parashkrimi rrjedh ves e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer"*. Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti, përkatësisht faturat mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbarrim e mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbarrimor janë përfshi në parashkrim, dhe si të tilla nuk mund t'i nënshtrohen përmbarrimit, rrjedhimisht edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit duhet të anulohet. Meqenëse gjykata ka aprovuar prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, me të cilin përcaktohet se: *"Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarrimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera"*, vendosi që procedura përmbarrimore në këtë çështje të përfundohet. Lidhur me shpenzimet e procedurës përmbarrimore gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-se, duke ia njohur shpenzimet përfaqësuesit të debitorit në emër të prapësimit të ushtruar, në vlerë prej 208.00 euro, konform rregullores në fuqi për tarifat e avokateve. Andaj edhe mbi bazën e këtyre fakteve gjykata e shkallës së parë e ka pranuar prapësimin e debitorit dhe ka anuluar urdhrin përmbarrimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarrim, që nuk është në përputhje me dispozitën nga neni 29 i Ligjit për Procedurën Përmbarrimore nr.04/L-139, ku përcakton se, Fatura Nr.49-2017 e datës 01.11.2017 dhe Fatura Nr. 52-2017 e datës 07.11.2017 dhe rrjedhimisht borxhi i cili buron nga faturat mbi bazën e se cilave është lejuar urdhri për përmbarrim, është përfshirë në parashkrim, kjo në përputhje me nenin 355, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili përcakton se: *"Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. 2. Parashkrimi rrjedh ves e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer"*. Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti, përkatësisht faturat mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbarrim e mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbarrimor janë përfshi në parashkrim, dhe si të tilla nuk mund t'i nënshtrohen përmbarrimit, rrjedhimisht edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit duhet të anulohet. E po ashtu edhe gjykata e shkallës së dytë, pajtohet në tërësi me qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë ky dokument përbën bazë juridike për caktimin e përmbarrimit, ngase nuk i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 të LPP-së, për faktin se ky dokument nuk e ka cilësinë e dokumentit përmbarrimor dhe urdhëri duhet që të anulohet. Gjithashtu sa i përket

shpenzimeve drejt ka vendosur gjykata shkallës së parë kur ka njohur shpenzimet në emër të debitorit, në shumë prej 208.00 euro konform rregullores në fuqi sipas tarifës së avokatëve.

Kjo gjykatë vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre rreth mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga raporti detyrimor dhe se fatura në fjalë, në këtë fazë, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si të tilla, janë të papërshtatshme për përmbarim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Gjykata e shkallës së dytë i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të kreditorit, por të njëjtat nuk ndikuan në një vendim ndryshe.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.1262/2024, me datë 01.11.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami, d.v